

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.03.2023*

01.03.2023
Ora 11:06

RENDI I DITËS

“Për shqyrtimin administrativ ndaj personave përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

KQZ

- | | |
|--|--|
| 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve | Z. Ilirjan Celibashi |
| 2. Stafi KQZ: | Z. Y. Merkaaj, Znj. I. Osmanaj,
Znj. A. Agolli |
| Parti Politike: | P L (Z. F. Guri) |
| OJQ: | KRIIK, |
| Të Tjerë: | Bashkia Belsh (Z. M. Çarçiu) |
| | Ministria Për Europën dhe Punët e Jashtme (Z. B. Hoxha) |
| | Ministri i Shtetit për Standartet e Shërbimeve (Znj. E. Zyfi) |

Z. I. Celibashi: Mirëmëngjes! Atëhere në seancën e sotme kemi në rend dite “Shqyrtimin administrativ ndaj personave përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të 14 maj 2023” është bazuar në denoncimet e palëve të treta apo jo, pika e parë e rendit të ditës. Kemi “Përfundimin e hetimit administrativ mbi raportimin e institucioneve publike për periudhën 10 shkurt - 16 shkurt”. Pika e tretë është “Vlerësimi i raportimit të veprimtarive të institucioneve publike për periudhën 17 shkurt – 23 shkurt”. Ndërkohë do të shtojmë në rendin e ditës.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.03.2023*

Z. Y. Merkaj: Edhe dy projektvendime të tjera për “Miratimin e modeleve të administratës zgjedhore që do të përdoren në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore” dhe “Për shqyrimin e kërkesës Komitetit Shqiptar të Helsinki” dhe “Organizatës Qendresa Qytetare për akreditimin e vëzhguesëve”.

Z. I. Celibashi: Dakord, mirë! Atëhere i përfshijmë edhe këto tre ccështje në rendin e ditës. Fillojmë me pikën e parë që ka të bëjë me shqyrtimin administrativ ndaj personave përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të institucioneve publike në kuadër zgjedhjeve të 14 majit 2023. Po Ina.

Znj. I. Osmanaj: Faleminderit Komisioner, së pari doja t’ju informoja në lidhje me denoncimet që deri më sot ka administruar Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Aktualisht kemi administruar 129 denoncime të përcjella për shkelje të parashikuara në nenin 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor sikurse dhe vendimi numër 9 datë 29.12.2020 të Komisionit Rregullator. 129 denoncimet janë të kategorizuara si më poshtë vijon:

- 5 raste janë përcjellë nga subjektet politike,
- 2 raste janë përcjellë nga organizata Qëndresa Qytetare,
- 1 rast është përcjellë nga sinjalizues,
- 121 raste janë përcjellë nga organizata KRIIK, (nga të cilat 107 raste janë raste për mosraportim të veprimtarive publike për 72 institucione publike, 4 raste janë për raportimin e veprimtarive pasi veprimtaria publike është zhvilluar për 3 institucione publike dhe 10 raste janë në kuadër të shkeljeve të detyrimeve të parashikuara nga neni 91 Kodi Zgjedhor).

Deri më sot Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka përfunduar hetimin administrativ dhe ka miratuar 15 vendime, nga të cilat 13 vendime janë për 13 institucione, për 19

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.03.2023*

veprimtari publike të paraportuara në ndërfaqen e dedikuar për raportimin e veprimtarive publike, 1 vendim është për denoncimin e përcjellë ndaj drejtorit të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës dhe 1 vendim është për denoncimin e përcjellë nga sinjalizuesi. Struktura përgjegjëse ka vijuar hetimin administrativ për secilën nga rastet objekt denoncimi dhe deri më sot ka përfunduar hetimi administrativ për 13 institucione publike për 24 veprimtari, për të cilat pretendohet nga denoncuesi se nuk janë raportuar në faqen e KQZ-së. Këta institucione janë: Ministria për Evropën dhe Punë e Jashtme, Ministri i Shtetit për Standarte dhe Shërbime, Bashkia Sarandë, Bashkia Libohovë, Bashkia Berat, Bashkia Përmet, Bashkia Vlorë, Bashkia Dibër, Bashkia Rogozhinë, Bashkia Tepelenë, Bashkia Belsh, Bashkia Shkodër, Bashkia Cërrik. Pas shqyrtimit të secilit rast objekt denoncimi dhe në përfundim të hetimit administrativ institucionet publike janë njoftuar për të marrë pjesë në seancën e sotme publike, për të argumentuar dhe shpjeguar arsyet e mosraportimit, të cilat pas verifikimit rezultojnë që janë veprimtari publike dhe mbartin detyrime për tu raportuar në faqen e KQZ-së. Aktualisht kanë ardhur 3 (tre) institucione: përfaqësues nga Bashkia Belsh, përfaqësues nga Ministria për Punët e Jashtme dhe përfaqësuesi i Ministrisë të Shtetit për Standarte dhe Shërbimet.

Z. I. Celibashi: Mirë, faleminderit Ina! Atëhere se unë nuk i njoh personalisht, sipas rradhës nga e majta në të djathtë ose nga e djathta në të majtë, të lutem mikrofonin, emër mbiemër dhe cilin institucion përfaqësoni.

Z. Mustafa Çarçiu, përfaqësues i Bashkisë Belsh: Unë quhem, Mustafa Çarçiu, përfaqësoj Bashkinë Belsh, jam në detyrë Sekretar i Përgjithshëm i bashkisë, dhe përfaqësuesi ndërlidhës midis bashkisë dhe KQZ-së. Ndihem shumë fajtor që jam këtu.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.03.2023*

Z. I. Celibashi: Nuk jeni aq i nderuar që jeni këtu! Dakord! Pra, nuk keni për të thënë ndonjë gjë më shumë nga ajo çfarë u prezantua nga stafi i KQZ-së.

Z. Mustafa Çarçiu, përfaqësues i Bashkisë Belsh: T'ju them për raportimin, se pse nuk kemi raportuar?

Z. I. Celibashi: Jo nëse ke, nëse dëshiron të thuash diçka!

Z. Mustafa Çarçiu, përfaqësues i Bashkisë Belsh: Unë në rradhë të parë kërkoj një falje që mosraportimi i aktiviteteve të faqja e KQZ-së ka ardhur për mungesë informacioni. Shkresa që ka ardhur nga KQZ-ja nr. 137, ka ardhur te ne në datën 13, por fatkeqësisht unë kam qenë dy javë në periudhë gripal. Pastaj ka qenë për neglizhencë deri në datën 21. Më vinin email-et e denoncimeve nga KQZ.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.03.2023*

Z. Mustafa Çarçiu, përfaqësues i Bashkisë Belsh: Kam kontaktuar me Bashkinë Cërrrik me një kolegun tim dhe ai më informoi që çdo bashki duhet të hapi një llogari dhe pajiset me një kod. Pastaj jam lidhur me përfaqësuesin e KQZ-së që mbulon Belshin znj.Klodiana Nogo që nuk e njoh fizikisht, po kam komunikim të mirë. Ajo më dha një numër tjetër dhe menjëherë hapëm faqen, hapëm llogarinë dhe kemi filluar me raportimet me datë 23 Shkurt dhe me datë 27 dhe në vazhdim, jemi korrekt. Tani, mbase nuk janë justifikime ndoshta nuk merren për bazë po kjo është e vërteta.

Z. I. Celibashi: Faleminderit për prezantimin dhe për sinqeritetin! Do ta vlerësojmë çfarë ju prezantuat këtu dhe do të viheni në dijeni për vendimin, që do të marrim. Zotëria në krah ju lutem!

Z. B. Hoxha përfaqësuesi i Ministrisë për Punët e Jashtme dhe Europën: Përshëndetje i nderuar Komisioner unë jam Blendi Hoxha, specialist në Drejtorinë e Plomacisë Publike dhe Diasporës në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtëme. Drejtoria jonë respektive, Drejtoria e Diplomacisë Publike është marrë me koordinimin e këtij eventi, nuk kam edhe unë shumë gjë për të shtuar por e vetmja arsye që mund të jap edhe unë ishte mungesa e informacionit për të raportuar tek KQZ. Sepse edhe aktiviteti ishte vet i tillë që ndodhi në punë ditësh, ndodhi në momentet e fundit pasi është zhvilluar tashmë si praktikë me Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme pasi është zhvilluar edhe dy vite më parë. Aktiviteti është kërkuar nga vetë “Qendra Rinore Hana” në fjalë me seli në Lezhë. Ajo që doja të theksoja në fakt është që nuk është mediatizuar nga Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme, vetëm është publikuar në rrjetet sociale të Ministrisë

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.03.2023*

së Europës dhe Punët e Jashtëme si aktivitet i institucionit rreptësisht teknik diplomatikë edhe kaq. Në qoftë se keni ndonjë pyetje?

Z. I. Celibashi: Jo, nuk kemi asnjë pyetje, faleminderit! Thjesht për ju një sjellje në vëmendje por edhe për kë do tjetër që do ta ketë rastin ta dëgjojë këtë thirrje. Karakterin publik veprimtaritë e kanë edhe në rastin kur ato pasqyrohen në rrjetet sociale dhe jo vetëm në mediat tradicionale radio, televizion apo në median e printuar. Kështu që ta keni ju dhe të tjerët në vëmendje këtë fakt. Po zotëria tjetër ju lutem!

Z. F. Guri, përfaqësues i PL: Përshëndetje i nderuar Komisioner, jam përfaqësues i një subjekti politik Fjoralid Guri, i Partisë së Lirisë.

Z. I. Celibashi: Keni ndonjë gjë për të shtuar?

Z. F. Guri, përfaqësues i PL: Jo, nuk kam ndonjë gjë për të shtuar do dëgjoj, dhe në fund fare të shohim.

Z. I. Celibashi: Në rregull! Ju lutem zonja.

Znj. E. Zyfi, përfaqësuese e Ministrisë së Shtetit për Standartet e Shërbimeve: Unë jam Edlira Zyfi, këshilltare e Ministrisë së Shtetit për Standartet e Shërbimeve. Në fakt unë dua të shtojë vetëm diçka përpos sqarimeve që na keni dhënë në adresën zyrtare për denoncimin e aktivitetit “sipërmarrja standartet dhe shërbimet arritjet dhe sfidat”. Javën e parë ne nuk kemi pasur kredenciale dhe sa i takon email të dytë të ardhur ditën e Premte për vizitën e punës në Malin e Zi, njoftimi zyrtar ne

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.03.2023*

na ka ardhur me datë 23 dhe po në datë 23 unë kam bërë raportimin në KQZ. Kështu që kjo është mungesa e një dite vonesë. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Atëhere, mbaruam me përfaqësuesit e institucioneve të cilat ishin në proces shqyrtimi. Atëherë, do të vlerësojmë me shkrim, jo vetëm institucionet që ishin sot me përfaqësues po edhe të tjerët kanë që prezantuar me shkrim shpjegimet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Besoj ditën e Premte do të bëjmë publike edhe vendimin tonë mbi gjithë gjykimin dhe vlerësimin e këtyre shqyrtimeve administrative. Faleminderit dhe e vlerësoj faktin që jeni përgjigjur ftesës së KQZ për të qenë prezent në këtë dëgjese por edhe për shpjegimet që keni prezantuar me shkrim. Faleminderit! Mund të qëndroni, mund të ikni është në vlerësimin tuaj.

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.01.03.2023*

01.03.2023
Ora 11:17

RENDI I DITËS

“Përfundimi i hetimit administrativ mbi raportimet e organeve publike për periudhën 10 shkurt – 16 shkurt 2023”.

PJESËMARRJA :

KQZ

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve	Z. Ilirjan Celibashi
2.Stafi KQZ:	Z. Y. Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Znj. A. Agolli
Parti Politike:	P L (Z. Fjoraldi Guri)
Të tjerë:	KRIIK

Z. I. Celibashi: Pika e dytë e rendit të ditës ka të bëjë me “Përfundimi i hetimit administrativ mbi raportimet e organeve publike për periudhën 10 shkurt – 16 shkurt”.

Znj. A. Agolli: Atëhere, në përfundim të shqyrtimit administrativ të raportimeve të institucioneve publike për periudhën 10 shkurt -16 shkurt 2023 ka përfunduar hetimi administrativ dhe janë administruar të gjithë provat, faktet dhe parashtrimet e institucioneve. Argumentet e parashtruara prej tyre qëndrojnë dhe i vlerësojmë si të qenësishme dhe për këtë arsye propozojmë përfundimin e procedimit administrativ ndaj institucioneve si vijon:

- Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes.
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
- Kuvendi.

**Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.01.03.2023*

- Banka e Shqipërisë.
- Agjencia Shtetërore e Kadastrës.
- Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional.
- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.
- Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.
- Bashkia Delvinë.
- Bashkia Fier.
- Bashkia Lushnje.
- Bashkia Mallakastër.
- Bashkia Përmet.
- Bashkia Shkodër.
- Bashkia Kuçovë.
- Teatri Kombëtar i Operas Baletit dhe Ansambli Popullor.
Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit Ambra! Atëherë, nga vlerësimi që ju i keni bërë të gjithë dokumentacionit në lidhje me raportin për këtë periudhë, nuk rezulton që të ketë shkelje administrative në lidhje me raportimin për periudhën 10 shkurt – 16 shkurt. Atëherë do të përfundojmë hetimin administrativ për raportimin e këtyre institucioneve për këtë periudhë pa sanksione administrative. Dakord!

Vendimi nr. 77

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.01.03.2023*

01.03.2023
Ora 11:19

RENDI I DITËS

“Vijimi i hetimit administrativ për shkelje të konstatuara për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, qendrore dhe vendore si dhe agjensive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, për periudhën 17 shkurt – 23 shkurt 2023”.

PJESËMARRJA :

KQZ

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve	Z. Ilirjan Celibashi
2.Stafi KQZ:	Z. Y. Merkaj, Znj. I. Osmanaj, Znj. A. Agolli
Parti Politike:	P L (Z. Fjoraldi Guri)
Të tjerë:	KRIIK

Z. I. Celibashi: Kalojmë tek pika e tretë “Vlerësim i veprimtarisë së institucioneve publike, për periudhën 17 shkurt – 23 shkurt 2023”.

Znj. A. Agolli: Për periudhën 17 shkurt – 23 shkurt 2023 janë raportuar në total 244 aktivitete nga 59 institucione. Nga këto 26 veprimtari të zhvilluara nga 17 institucione janë në shkelje të afatit ligjor për raportim. I kemi kërkuar informacion institucioneve për të dhënë shpjegimet dhe pretendimet e tyre dhe deri më sot 12 institucione kanë paraqitur parashtrime. Jemi në vijim të shqyrtimit të pretendimeve të paraqitura. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: I keni caktuar një afat brenda të cilit duhet të sjellin parashtrimet dhe shpjegimet e tyre?

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*

P *Merkaj*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.01.03.2023*

Znj. A. Agolli: Po! Jemi në pritje ende.

Z. I. Celibashi: Ideja është që deri ditën e premte ne mund të vendosim.

Znj. A. Agolli: Po!

Z. I. Celibashi: Mirë, dakord! Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*

p *Derwish*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.01.03.2023*

01.03.2023
Ora 11:20

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për miratimin e modeleve të procesverbaleve të administratës zgjedhore që do të përdoren në zgjedhje”.

PJESËMARRJA :


KQZ

- | | |
|--|--|
| 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve | Z. Ilirjan Celibashi |
| 2. Staf i KQZ: | Z. Y. Merkaj, Znj. I. Osmanaj,
Znj. A. Agolli |
| Parti Politike: | P L (Z. F. Guri) |
| OJQ: | KRIIK, |

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me disa ndryshime të karakterit teknik të procesverbaleve që do të përdorin KZAZ-të dhe KQV-të.

Z. Y. Merkaj: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka planifikuar praktikën në datën 03.02.2023, me vendim numër 33 ka miratuar modelet e procesverbaleve, përmbajtjen dhe specifikimet e tyre. KQZ-ja gjatë organizimit të trajnimeve të administratës zgjedhore të nivelit të dytë ka vërejtur se nga ana e administratës është kërkuar që titujt e procesverbaleve dhe dizenjimi i tyre të ishte më i lehtë dhe më i uniformëzuar me qëllim administrimin e këtij dokumentacioni nga administrata zgjedhore. Në këtë kuadër po administrata e KQZ-së po propozon risjelljen e këtij projektvendimi me saktësimin e emërtesës dhe një pjese dalluese të tyre ndonëse përmbajtja thelbësore nuk ndryshon. Duke qenë se këto materiale ende nuk janë

**Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.01.03.2023*

prodhuar dhe ende nuk kanë kaluar në fazën e trajnimit masiv të administratës zgjedhore kemi sjellë projektvendimin e mësipërm për shqyrtim dhe miratim nga ana juaj. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Mirë, dakord! I kalojmë ndryshimet sipas asaj çfarë është propozuar nga ana juaj.

Vendimi nr. 78

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.01.03.2023*

01.03.2023
Ora 11:21

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për miratimin e vëzhguesve afatgjatë të Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe Qëndresa Qytetare për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

KQZ


- | | |
|--|--|
| 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve | Z. Ilirjan Celibashi |
| 2. Stafi KQZ: | Z. Y. Merkaj, Znj. I. Osmanaj,
Znj. A. Agolli |
| Parti Politike: | P L (Z. F. Guri) |
| OJQ: | KRIIK, |

Z. I. Celibashi: Kemi 2 kërkesa për akreditim vëzhguesish, Komiteti Shqipëtar i Helsinkit dhe Qëndresa Qytetare.

Z. Y. Merkaj: Kanë kërkuar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve akreditimin e 28 vëzhguesve Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe organizata Qëndresa Qytetare ka akreditimin e 30 vëzhguesve afatgjatë dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesat e paraqitura respektojnë afatin kohor si dhe kanë të drejtë për të marrë pjesë dhe për të caktuar vëzhgues në zgjedhje. Kështu që i propozojmë Komisionerit të miratojë listën e vëzhguesve. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Përfaqësuesi i Partisë Lirisë në lidhje më këtë?

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Dt.01.03.2023*

Z. F. Guri, përfaqësues i Partisë së Lirisë: Nuk kemi asgjë, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Mirë atëherë, miratojmë kërkesën e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe të Qëndresës Qytetare për akreditimin e disa vëzhguesve për zgjedhjet e datës 14 Maj 2023. Çështje të tjera?! Nuk kemi në rendin e ditës! Mirë, faleminderit! Seanca mbyllet! Ditë të Mbarë!

Vendimi nr. 79

**Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI**

